



KOMENTET E KRYETARIT TË PREZENCËS PËR SITUATËN ZGJEDHORE DHE POLITIKE, I PYETUR NGA GAZETARËT, NË FUND TË NJË VEPRIMTARIE

5 prill 2013

Raporti i ODIHR-it flet për një polarizim të klimës politike, e cila do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në zhvillimin demokratik të zgjedhjeve. A ndani edhe ju të njëjtin shqetësim?

Ambasadori Wollfarth: “ODIHR-i botoi dje pasdite raportin e Misionit për Vlerësimin e Nevojave. Në të reflektohen ato që ata kanë dëgjuar nga bashkëbiseduesit gjatë misionit të tyre këtu. Unë do ta vija theksin te pjesa më e rëndësishme e raportit, që është rekomandimi për të pasur një numër të madh vëzhguesish këtu në terren për të lehtësuar një procedurë të saktë zgjedhore. Ka shume gjasa që të vijnë më shumë se 400 vëzhgues, vetëm ga ODIHR-i, ditën e zgjedhjeve në Shqipëri dhe kjo është një mbështetje shumë e madhe për një proces të mirë zgjedhor këtu në Shqipëri.

Më lejoni të shtoj, gjithashtu, që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, po bën një punë shumë të mirë dhe kjo jo në rrethanat më të lehta të mundshme. Kjo është, gjithashtu, thelbesore për një proces të mirë zgjedhor. Deri tani, jemi në terren të sigurt. Do të doja të shtoja që kjo është vënë re dhe vlerësuar që nga ana e qeverisë ekziston mbështetja për një proces të rregullt zgjedhor. Ky është një angazhim tjetër shumë i rëndësishëm, të cilin ne e mbështesim plotësisht.”

A keni koment për largimin nga koalicioni të z. Meta?

Ambasadori Wollfarth: “Këto janë vendime legjitime që bëhen nga partitë politike. Nuk kam asnjë koment për të bërë në këtë fazë.”

Në fakt, kjo do të ndikojë në administrimin e zgjedhjeve, pasi opozita, së bashku me LSI-në do të administrojnë 100% të KZAZ-ve dhe vendeve të numërimit. Si e shikoni këtë zhvillim?

Ambasadori Wollfarth: “Nuk kam të njëjtin mendim. Komisionerët duhet të bëjnë një punë neutrale dhe korrekte. Ata kanë besimin e partive te tyre. Ata duhet të punojnë për përmbushjen e detyrës dhe zbatimin e ligjit. Kjo është një detyrë në shërbim të qytetarëve, të të gjithë shqiptarëve.”

Fund